



MINISTRIA PËR EUROPËN DHE PUNËT E JASHTME QENDRA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT



Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshëtnr. 601, datë 04.09.2019 si dhe Ligjit nr. 7961, datë 12. 7. 1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, QSPA do të shpallë në faqen zyrtare të internetit konkursin për pozicionin:

PASQYRA E PUNËS

POZICIONI I PUNËS	Specialist Kërkues shkencor- Gjuhëtar
DEPARTAMENTI	Drejtoria e Studimeve dhe Publikimeve
ADRESA E QSPA	Rruga “Skënderbej”, pll 8/3, Ap.40, Tiranë
RAPORTON TEK	Drejtori i Drejtorisë së Studimeve dhe Publikimeve

PËRSHKRIMI I PUNËS

Objekti i punës së **Specialist Kërkuesit shkencor pranë** Drejtorisë së Studimeve dhe Publikimeve është:

- Konceptimi, organizimi dhe realizimi i kërkimeve dhe studimeve të thelluara në lëmitë e ndryshme të spektrit arbëresh;
- Zhvillimi i projekteve që hyjnë në fushën e veprimit të QSPA-së, duke mobilizuar e bashkërenduar burime njerëzore dhe materiale brenda dhe jashtë QSPA-së;
- Nxitja e këtyre kërkimeve nëpërmjet organizimit të seminareve, konferencave , takimeve apo eventeve;
- Valorizimi i rezultatit të këtyre aktiviteteve nëpërmjet publikimeve dhe akteve të tjera njohëse dhe promovuese.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Kryen studime themelore në fushën e tij/ saj të specialitetit, e cila është një nga disiplinat, apo një kombinim i disiplinave të shkencave sociale të aplikuara mbi komunitetet arbëreshe si:
 - Gjuhësi
- Shkruan dhe publikon, në suportet e QSPA-së si faqja web dhe suportet e tjera të komunikimit elektronik, botimet e QSPA-së, aktivitetet, shtypin periodik të QSPA-së etj;
- Merr pjesë në organizimin e konferencave dhe seminareve shkencorë, të cilat i mbështet me ide, përmbajtje dhe organizim;
- Të jetë i aftë të realizojë, përveç kërkimit shkencor në disiplinën përkatëse, një apo disa nga aktivitetet që hyjnë në objektin e punës së Drejtorisë së Studimeve dhe Publikimeve, të cilat do ti caktohen nga eprrori sipas nevojave të kalendarit të veprimtarive;

EDUKIMI DHE TRAJNIMET

Specialisti i punësuar në këtë kategori duhet të plotësojë këto kritere:

- Të zotërojë gradë/titull shkencor “Doktor” në fushën e Gjuhësisë.(Parapëlqehet të ketë patur përvojë në kërkime që prekin fushën e studimeve mbi arbëreshët);
- Të ketë të paktën 5 vite eksperiencë pune në fushën e kërkimit shkencor për të cilën punësohet;
- Të ketë njohuri mbi historinë e Arbëreshëve;
- Të ketë aktivitet kërkimor-shkencor dhe botime në disipinën përkatëse.

KËRKESAT

- Të përmbushë kriteret e punësimit që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të jetë i certifikuar në gjuhë të huaj, minimumi niveli C1 (Italisht ose Anglisht).

AFTËSITË

- Aftësi vendimmarrëse dhe interpretuese;
- Aftësi pune në grup;
- Komunikim shumë i mirë;
- Aftësi të mira në përballimin e punës nën presion.

KUSHTET E PUNËS

MJEDISI I PUNËS	Mjedisi i punës, karakterizohet nga ambientet e përshtatshme dhe të mirë organizuara për punën kërkimore e studimore.
ORARI I PUNËS	Nga e hëna në të enjte, orari është nga ora 08:00 deri në orën 16:30. Ditën e premte, orari është nga ora 08:00 deri në orën 14:00.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë, duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim ku shpreh interesin për të aplikuar për pozicionin e punës.
2. Jetëshkrim (CV) në formatin Euro Pass.
3. Fotokopje të diplomave universitare dhe të titullit “Doktor”
4. Referencë nga të paktën një profesor
5. Fotokopje të librezës së punës ose vërtetime nga punëdhënësit, të cilat vërtetojnë eksperiencën në punë.
6. Kopje të artikujve, teksteve, revista, projekte shkencore etj.
7. Certifikata që vërtetojnë zotërimin e gjuhës së huaj

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve të bëhet brenda datës **05/11/2024 ora 16:30**, në Zyrën e Protokollit të QSPA-së në Rruga “Skënderbej”, pll 8/3, Ap.40, Tiranë, si dhe në adresën e e-mail: **info@qspa.gov.al**

Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë të cilat do të zhvillohet intervista:

- Njohuri mbi ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".
- VKM nr. 601, datë 04.09.2019 “Për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

Faza e parë:

Në fazën e parë kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

- Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv.

Faza e dytë: Intervista e strukturuar me gojë

Intervista e strukturuar me gojë do të realizohet në ambjentet e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, në ditën dhe orarin që do t'ju njoftohet me e-mail..

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e konkurrimit

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga QSPA-ja, për rezultatet, pas zhvillimit të intervistës me gojë (nëpërmjet adresës së e-mail).